



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 korrik 2022
Nr.ref.: RK 2020/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI140/21

Parashtrues

Menderes Sinani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit, Pml. nr. 34/2021 të 19 prillit 2021, të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Menderes Sinani, me vendbanim në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Burhan Qosa, avokat nga komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 34/2021] të 19 prillit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 282/2020] e 6 nëntorit 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 173/2017] e 12 marsit 2020 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 12 maj 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, nëpërmjet të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) dhe 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu- Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 14 shtator 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi që të dorëzojë autorizim të vlefshëm si dëshmi e përfaqësimit të tij në Gjykatë.
9. Më 29 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
10. Më 1 dhjetor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 4 prill 2022, Gjykata nga Gjykata Themelore në Ferizaj kërkoi, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, të dorëzojë si dëshmi fletëkthesën për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
12. Më 7 prill 2022, Gjykata Themelore në Ferizaj informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 maj 2021.

13. Më 26 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi shtyrjen e vendimmarrjes së rastit për një seancë të radhës shqyrtuese.
14. Më 22 qershor 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

15. Më 27 dhjetor 2013, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngrii aktakuzë [PSS. nr. 05/12] në Gjykatën Themelore, kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin se i njëjti ka kryer veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar; Marrja e ryshfetit; Bashkëkryerja; Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale; dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, të Kodit [Nr. 04/L-082] Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: KPRK). Me të njëjtën aktakuzë për veprat penale të lartcekura në bashkëkryerje ishin akuzuar edhe personat B. Sh., B. V., S. M. dhe R. A.
16. Më 6 tetor 2016, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 250/2013], shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës duke i shqiptuar dënim me burgim prej 7 (shtatë) vitesh.
17. Më 26 janar 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.
18. Më 14 nëntor 2017, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [PAKR. nr. 77/2017], anuloi Aktgjykimin [P. nr. 250/2013] e Gjykatës Themelore të 6 tetorit 2016, me arsyetimin se i njëjti nuk i përmbush kërkesat e parapara nga paragrafi 1.12 të nenit 384, në lidhje me nenin 370 të Kodit [Nr. 04/L-123] të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: KPPRK).
19. Më 12 mars 2020, Gjykata Themelore, duke vendosur në riprocedurë, nxori Aktgjykimin [PKR. nr. 173/2017], nëpërmjet të cilit e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe ia shqiptoi:
 - (i) dënimin me burgim në kohëzgjatje për 3 (tre) vjet, për kryerjen e veprës penale *“marrja e ryshfetit”*, përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 343, paragrafi 1, lidhur me nenin 23 të KPRK-së;
 - (ii) dënimin me burgim në kohëzgjatje për 1 (një) vit, për kryerjen e veprës penale *“dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale”*, përcaktuar me nenin 388, paragrafi 1 dhe 2 i KPRK-së;
 - (iii) dënimin me burgim në kohëzgjatje për 6 (gjashtë) muaj për *“mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, përcaktuar me nenin 374, paragrafi 1, i KPRK-së;
 - (iv) urdhëroi parashtruesin e kërkesës që bashkë me të dënuarin B. Sh., t’ia kompensoj të dëmtuarit B. S., dëmin material në vlerë prej 4750 euro, ndërsa palën e dëmtuar e ka udhëzuar që ta realizoj kërkesën pasurore në kontest civil.
20. Gjykata në fjalë, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 80 të KPRK-së, parashtruesit të kërkesës ia shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjet dhe 3 (tre) muaj, duke ia llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, nga 11 shtatori 2013 deri më 14 nëntor 2017. Ndërsa për shkak të parashkrimit absolut, nëpërmjet të njëjtit aktgjykim Gjykata Themelore, refuzoi aktakuzat në ngarkim të tij, lidhur me veprat penale:

- (v) *“shpërdorim i detyrës zyrtare në bashkëkryerje”*, nga neni 339, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe me nenin 23 të KPRK-së;
 - (vi) *“ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje”*, nga neni 345, paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së;
 - (vii) *“shmangie nga pagesa detyrueshme e taksave doganore në bashkëkryerje”*, nga neni 318, paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
 - (viii) *“dhënie të ndihmës kryerësve, pas kryerjes së veprës penale”*, nga neni 388, paragrafi 1, i KPRK-së ; dhe
 - (ix) *“moslajmërim i veprave penale, apo i kryerësve të tyre”*, nga neni 386, paragrafi 1, pika 9 i KPRK-së.
21. Përveç kësaj, Gjykata Themelore me Aktgjykimin [PKR. nr. 173/2017], të 12 marsit 2020, parashtruesin e kërkesës dhe të bashkëakuzuarin B. Sh, i detyroi që t’ia kompenzonin të dëmtuarit B. S. dëmin material të shkaktuar në shumën prej 4750 euro. Parashtruesit të kërkesës po ashtu iu konfiskua në mënyrë të përhershme municioni i konfiskuar më parë përkohësisht, si dhe mjetet monetare të sekuestruara, si produkt i veprës penale. Pala e dëmtuar me këtë rast u udhëzua që kërkesat pasurore juridike t’i realizonte në kontest civil.
 22. Më 13 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 173/2017] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi sanksionin penal, dhe vendimit të konfiskimit të dobisë pasurore. Në ankesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera kishte pretenduar shkelje të paragrafit 9 të nenit 370 dhe nënparagrafit 1.12 të nenit 384, si dhe nenit 386 të KPRK-së, me arsyetimin se Gjykata Themelore nëpërmjet aktgjykimit të saj nuk kishte shpjeguar se si e kishte vërtetuar gjendjen faktike, konkretisht se si mjetet monetare të konfiskuara përmes vendimit të Gjykatës Themelore në shumë prej 4090 euro ishin produkt i veprës penale.
 23. Kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 173/2017] të Gjykatës Themelore, gjithashtu Prokuroria Themelore parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet së cilës kërkoi shqiptim më të ashpër të sanksioneve penale ndaj parashtruesit të kërkesës. Po ashtu, Prokuroria e Apelit i propozoi Gjykatës së Apelit që të aprovojë ankesën e Prokurorisë Themelore dhe të refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës në të gjitha bazat e kontestuara.
 24. Më 6 nëntor 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit [PAKR. nr. 282/20], refuzoi, si të pabazuara, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorisë Themelore dhe konfirmoi Aktgjykimin [PKR. nr. 173/2017] e Gjykatës Themelore, të 12 marsit 2020, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.
 25. Më 18 janar 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 282/20] të Gjykatës së Apelit, të 6 nëntorit 2020 dhe Aktgjykimit [PKR. nr. 173/17] të Gjykatës Themelore, të 12 marsit 2020, duke pretenduar shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, pika 12, lidhur me nenin 370 paragrafi 6, 7 dhe 11 të KPRK-së. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme pretendonte edhe shkelje të nenit 385, 394 si dhe 432 të KPRK-së, për shkak se gjykatat e rregullta në vendimet e tyre nuk kanë dhënë arsyetim lidhur me vlerësimin e provave dhe mënyrën e vërtetimit të përgjegjësisë penale ndaj parashtruesit të kërkesës. Po ashtu parashtruesi i kërkesës si pretendim para Gjykatës Supreme e ngriti edhe çështjen e konfiskimit të mjeteve monetare që i ishin sekuestruar atij, me arsyetimin se ato mjetë monetare ishin produkt i veprës penale.

26. Më 19 prill 2021, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit [Pml. nr. 34/2021] e aprovoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke ndryshuar Aktgjykimin [PARK. nr. 282/20] e Gjykatës së Apelit, të 6 nëntorit 2020 dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 173/17] e Gjykatës Themelore, të 12 marsit 2020, në pjesën që kishte të bënte me konfiskimin e mjeteve monetare, të sekuestruara, e të cilat ishin produkt i veprës penale, duke ia kthyer kështu këto mjete monetare parashtruesit të kërkesës. Në pjesët tjera, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i 19 prillit 2021, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese, konkretisht të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 8 (E drejta për respektimin e të drejtës private dhe familjare) të KEDNj-së.

i. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së

a) përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar

28. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [PKR. nr. 173/17] i Gjykatës Themelore në Ferizaj është i përfshirë me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, sepse *“Gjykata Themelore në Ferizaj me rastin e rigjykit të çështjes penale, nuk i ka marrë për bazë dhe fare nuk i ka trajtuar në mënyrë objektive të gjeturat e Gjykatës së Apelit të cekura si në aktvendimin PAKR.nr.77/2017, dt. 14 nëntor 2017”*. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Themelore në Ferizaj në riprocedim të çështjes penale ndaj tij, vetëm se ka përshtetur (kopjuar) pjesë nga Aktgjykimi P. nr. 250/13, i 6 tetorit 2016, ku për pasojë ai me Aktgjykimin PKR. nr. 173/17, të 12 marsit 2020 është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Ferizaj, bazuar në prova artificialisht inkriminuese ndaj tij, duke shkelur kështu parimet themelore të procedurës penale, siç është prezumimi i pafajësisë dhe gjykimi i drejtë.
29. Parashtruesi i kërkesës, tutje pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 282/20, i 6 nëntorit 2020 është i përfshirë në shkelje kushtetuese të nenit 31, dhe të nenit 6 të KEDNj-së, sepse çdo paragraf i tij është marrë në kundërshtim me nenin 401 të KPPRK-së, pasi që kjo gjykatë ka konfirmuar Aktgjykimin [PKR. nr. 173/17] e Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 12 marsit 2020, pa asnjë arsyetim të artikulueshëm dhe në shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, lidhur me nenin 370, paragrafin 6, 7, 9 dhe 11 të KPPRK-së, duke dyshuar se Gjykata e Apelit fare nuk i ka lexuar pretendimet ankimore të tij të paraqitura në ankesë, dhe se *“ai aktgjykim nuk vërteton asgjë përveç faktit se parashtruesit të kësaj kërkesë, i mohon të drejtën e tij të garantuar me Kushtetutë për gjykim objektiv të drejtë dhe të paanshëm”*.
30. Parashtruesi i kërkesës, përveç tjerash, pretendon se edhe Aktgjykimi i kontestuar [Pml. nr. 34/202] i Gjykatës Supreme, i 19 prillit 2021 është i përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, për arsye se *“... ai aktgjykim nuk është fare objektiv dhe mbështetet në arsyetim të paqëndrueshëm, ngase ligjërisht është i papranueshëm dhe joobjektiv arsyetimi i Gjykatës Supreme”*, duke theksuar se kjo e fundit *“... ka tentuar në një ose formë tjetër që fajin për dënimin që kishte marrë z. Sinani t’ia faturojë mbrojtjes së tij, kinse mbrojta nuk e paska paraqitur në mënyrë të kuptueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, fakt ky i cili nuk qëndron pasi që fare mirë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dt. 08.01.2021 në pikën (1) faqe 6, mbrojtja ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që edhe njëherë të trajtohen të*

gjitha pretendimet ankimore të bëra nga mbrojtja, si në Ankesën e dt.13.07.2020 të bëra nga z. Sinani, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj PKR.nr.173/17, dt.12.mars 2020”.

b) përkitazi me “pranueshmërinë e provave”

31. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkesës thekson se “... të gjitha aktgjykimet e atakuara me këtë kërkesë janë pjellë e një prove të papranueshme siç është Shtojca e Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë të të pandehurit B. Sh., Rasti nr. 51/13”. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se me asnjë provë tjetër nuk është vërtetuar fajësia e tij për veprat penale për të cilat ai është shpallur fajtor nga gjykatat e rregullta, nisur dhe nga fakti se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë (PPKR. nr. 250/13, PPS:05/2012 dhe PP.51/13, e 29 prillit 2015), si dhe shtojcën e saj, i dënuari B. Sh. nuk i ka nënshkruar, por ai gjatë fazës së marrjes në pyetje ka deklaruar se ka nënshkruar një marrëveshje ku ka pranuar fajësinë vetëm për vete, duke shtuar se ai nuk ka qenë asnjëherë i thirrur si dëshmitarë bashkëpunues, dhe duke qenë se edhe vet gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin P. nr. 250/13, të 6 tetorit 2016, marrëveshjen në fjalë, e kishte cilësuar si të papranueshme në këtë fazë të procedurës, përderisa gjykimi ishte në vazhdim e sipër. Tutje parashtruesi i kërkesës pretendon se sipas kësaj marrëveshjeje i pandehuri B. Sh. kishte statusin e dëshmitarit bashkëpunues, e që e njëjta ishte konsideruar si provë e papranueshme “... jashtë nivelit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në atë fazë të procedurës”.

ii. Pretendimet për shkelje të nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 të KEDNj-së

32. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon në shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNj-së, me pretendimin se në pikën 4 dhe 6 të shtojcës së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e të dënuarit B. Sh., të 29 prillit 2015, atij si person i është zbuluar jeta private dhe familjare, për faktin se nga kjo marrëveshje janë cituar pjesë të deklarimeve të të dënuarit B. Sh. të cilat flasin për raportet e tij private me familjen (gruan e tij), e të cilat nuk ndërlidheshin asgjë me pranueshmërinë e provave.
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. nr. 34/2021] e Gjykatës Supreme dhe ta kthej rastin në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 36 **[E Drejta e Privatësisë]**

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banesë ose cilido objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Neni 8 **(E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)**

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
[...]
7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
[...]
36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

37. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 34/2021] të Gjykatës Supreme, të 19 prillit 2021; ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në aspektin procedural, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar saktësisht të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur nga autoritetet publike, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

38. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (1, b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:
- (1) *“Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*
 [...]
 (b) *janë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose aktvendimit të kontestuar;*
 [...]”
- (2) *Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, kategoria (iii)).
40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36 [E Drejta e Privatësisë], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të KEDNj-së.
41. Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës që ndërliiden me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e privatësisë, Gjykata do të aplikojë praktikën e saj dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Vlerësimi i pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së

42. Sa i përket pretendimeve të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, parashtuesi i kërkesës thekson që aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk i kanë arsyetuar në mënyrë të artikulueshme konkluzionet e tyre për t'iu përgjigjur pretendimeve të tij dhe se gjykatat e rregullta e kanë bazuar vendimmarrjen e tyre në prova të papranueshme, përkatësisht shpallja fajtorë e tij është bazuar në deklaratën e B. Sh., i cili kishte arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë përkitazi me akuzat e ngarkuara.
43. Në vijim, për sa i përket pretendimit për (I) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e ndërlidhura të parashtuesit të kërkesës për shkelje të garancive procedurale të garantuara me këto nene, duke vlerësuar esencën e pretendimeve, në lidhje me:
- (i) shkeljen e të drejtës për një vendim të arsyetuar;
 - (ii) pranueshmërinë dhe administrimin e provave.

(i) Sa i përket shkeljes së të drejtës për një vendim të arsyetuar

a) parimet e përgjithshme

44. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019, KI35/18, parashtues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
45. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
46. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi

për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih, rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

47. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, rastet e Gjykatës nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; KI87/18 parashtrues "*IF Skadeforsikring*", Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).
48. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

b) aplikimi i këtyre parimeve në rastin konkret

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij për mungesë të vendimit të arsyetuar i ndërlidhë me mostrajtimin e pretendimeve të ngritura para gjykatave të rregullta, duke shtuar se gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë objektive dhe të artikulueshme vendimmarrjen e tyre.
50. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Themelore në Ferizaj me rastin e rigjyimit të çështjes penale, nuk i ka marrë për bazë dhe fare nuk i ka trajtuar në mënyrë objektive të gjeturat e Gjykatës së Apelit të cekura si në Aktvendimin PAKR. nr. 77/2017, dt. 14 nëntor 2017*".
51. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur edhe nëpërmjet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila arsyetoi, si në vijim: "*Gjykata Supreme konstaton se pretendimi se në rigjykim nuk janë respektuar vërejtjet e dhëna në aktvendimin me të cilin aktgjykimi paraprak është anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim nuk janë të bazuara, sepse siç u cek më lart, ... ai aktgjykim nuk është objekt i kundërshtimit me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, pastaj në rigjykim janë marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët dëgjimi i të cilëve është kërkuar, ndërsa pretendimi për "vendosje vetëm sa për të vendosur", për inatet dhe xhelozinë në mes gjyqtarëve, janë paushalle, të papranueshme dhe nuk kanë vend në këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik*".

52. Tutje, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë në shkelje kushtetuese të nenit 31, dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi që kjo gjykatë ka konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR. nr. 173/17 të 12 marsit 2020, pa asnjë arsytim të artikulueshëm dhe në shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, lidhur me nenin 370 paragrafin 6, 7, 9 dhe 11 të KPPRK-së”. Në këtë kontekst, parashtuesi i kërkesës pretendon se edhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 34/202, i 19 prillit 2021 është përfshirë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se kjo e fundit “... ka tentuar në një ose formë tjetër që fajin për dënimin që kishte marrë z. Sinani t’ia faturojë mbrojtjes së tij, kinse mbrojtja nuk e paska paraqitur në mënyrë të kuptueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, fakt ky i cili nuk qëndron pasi që fare mirë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dt. 08.01.2021 në pikën (1) faqe 6, mbrojtja ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që edhe njëherë të trajtohen të gjitha pretendimet ankimore të bëra nga mbrojtja, si në Ankesën e dt.13.07.2020 të bëra nga z. Sinani, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore Ferizaj PKR.nr.173/17, dt.12.mars 2020”.
53. Gjykata vëren se pretendimeve të mësipërme, Gjykata Supreme, i është përgjigjur, si në vijim: “Sa i përket gjetjeve në aktgjykimin e shkallës së parë i cili është vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, në kërkesë pretendohet se janë vendime pa arsye të bazuara, bindëse dhe të artikulueshme, nuk përmbajnë as arsytim se cilat fakte janë vërtetuar, për saktësinë e provave kundërtënëse e as për atë se në cilat fakte janë bazuar gjykatat me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike dhe vërtetimit të përgjegjësisë penale e të dënuarit. Gjykata Supreme e vlerësoi edhe këtë pretendim por nga i njëjti nuk u kuptua se konkretisht për cilat pjesë të aktgjykimeve bëhet fjalë, cilat janë rrethanat dhe faktet të cilat nuk janë arsyetuar, si janë manifestuar këto shkelje dhe në mungesën e pretendimeve konkrete, kjo gjykatë është e lidhur me dispozitën e nenit 436.par.1 të KPPK-së, sipas së cilës mund t’i shqyrtojë vetëm ato shkelje ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon, ashtu që këto pretendime nuk ishin të kuptueshme ndërsa ekzistimin e tyre Gjykata Supreme nuk mund t’i shqyrtoj sipas detyrës zyrtare.
54. Për më tepër, Gjykata Supreme, arsyetoi se “... në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ishin paraqitur dy pretendime konkrete të cilat do të vlerësohen në vijim. Pretendimi i parë ishte se i bashkëakuzuari i të dënuarit Menderes Sinani, në kryerjen e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343, par.1. lidhur me nenin 23 të KPK, B. Sh., në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.04.2019. ka deklaruar se paratë që i ka marrë nga Xh. B., (parat e ryshfetit) nuk ia ka dhënë të dënuarit Menderes Sinani. Gjykata Supreme konstaton se parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur deklaratën e tërësishme të dëshmitarit B. Sh., sepse ai ka deklaruar se sa i përket bashkëkryerjes së veprës penale me të dënuarin Menderes Sinani qëndron pranë pranimi të fajësisë, e në anën tjetër gjykata e shkallës së parë ka administruar, vlerësuar dhe arsyetuar shumë prova për bashkëkryerjen e tyre, prej të cilave këtu do përmenden ato siç janë se bashkërisht shumë herë kanë kontaktuar drejtë për së drejti me të dëmtuarin B. S. dhe familjarët e tij, e kanë vizituar në shtëpinë e tij, janë takuar në restorante dhe vende tjera, i kanë përsëritur kontaktet edhe kur ai për herë të dytë është paraburgosur, kanë potencuar se “do t’i ndihmojnë në çështjen penale të veprës së trafikimit me njerëz, ashtu që nuk ishte relevante se konkretisht cilit prej tyre i është dorëzuar ryshfeti, por se janë plotësuar të gjitha elementet thelbësore të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343. par.1. të KPK-së”.
55. Nga sa më sipër, Gjykata thekson se pretendimet e parashtuesit të kërkesës, se gjykatat e rregullta, përfshi Gjykatën Supreme nuk arsyetuan në mënyrë të artikuluar vendimmarrjen e tyre nuk qëndrojnë ngase gjykatat e rregullta në mënyrë të vazhdueshme trajtuan dhe arsyetuan bazueshmërinë e pretendimeve të tij, në kuptim

të ligjit dhe të provave të administruara, të cilat parashtuesi i kërkesës i kishte përsëritur nga një instancë në tjetrën. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjigjur në çdo pikë të ngritur nga parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61), ajo i ka adresuar argumentet thelbësore të parashtuesit të kërkesës për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25), dhe kështu është përmbushur obligimi për të ofruar një vendim të arsyetuar gjyqësor sipas kërkesave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

56. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në kuptim të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, është detyrim i gjykatave që argumentet thelbësore të parashtuesit të kërkesës të adresohen dhe arsyet e dhëna përkitazi me to, të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm. Gjykata, në këtë kontekst konsideron se pretendimeve të përsëritura të parashtuesit të kërkesës u janë përgjigjur me korrektësi gjykatat e rregullta dhe së fundmi Gjykata Supreme, Aktgjykimi i së cilës kontestohet në Gjykatë, andaj në këtë këndvështrim ato (gjykatat) kanë përmbushur këtë standard të kërkuar nga nenet e sipërcekura.
57. Gjykata tutje, rikujton se dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe të njëjtat dispozita as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17 parashtues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtuese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48, dhe së fundmi rastin KI68/21, parashtues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 8 shtatorit 2021, paragrafi 51).
58. Gjykata, gjithashtu, e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe së fundmi rastin e Gjykatës KI68/21, parashtues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 8 shtatorit 2021, paragrafi 52 dhe rastet e cituara aty).
59. Në këtë aspekt, Gjykata, shikuar procedurën në tërësi, konstaton se në rastin e parashtuesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga gjykatat e rregullta, të cilat e bëjnë gjykimin të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së. Gjykata në këtë rast vëren se parashtuesi i kërkesës thjeshtë nuk është pajtuar me rezultatin e procedurës dhe të gjyimit të çështjes së tij pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

60. Andaj, nga arsyet e lartcekura, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtresit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, përkatësisht të së drejtës për një vendim të arsyetuar i përkasin kategorisë (iii), nënkategorisë (b), të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, të njëjtat i shpallë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

i. Sa i përket pranueshmërisë dhe administrimit të provave

a) parimet e përgjithshme

61. Përkitazi me pranueshmërinë dhe ligjshmërinë e marrjes së provës, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së GJEDNj-së e cila, në parim ka theksuar se *“Indonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provës, si të tillë, një fushë kjo cila në radhë të parë i përkiste të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare”* (shih, rastet e GJEDNj-së *Schenk kundër Zvicrës*, nr. 10862/84, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46 dhe *Heglas kundër Republikës Çeke*, nr. 5935/02, Aktgjykimi i 1 marsit 2007, paragrafi 84). Aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih, rastin e Gjykatës KI230/19, cituar më lart, paragrafi 102; shih gjithashtu rastin e GJEDNj-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, Aktgjykim i 12 majit 2000, paragrafi 34; *P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48539/99, Aktgjykim i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
62. Në parim, nuk i takon Gjykatës Kushtetuese që të shprehet rreth pranueshmërisë së disa provave, për shembull të atyre të marra në kundërshtim me të drejtën kombëtare. Pika që duhet të shqyrtohet është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj, çka nënkupton shqyrtimin e paligjshmërisë në fjalë dhe në ato raste kur dyshohet për shkeljen e një të drejte tjetër të mbrojtur nga KEDNj, të natyrës së kësaj shkeljeje (Rasti i GJEDNj-së *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 34; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, Aktgjykim i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, , paragrafi 42).
63. Në këtë kontekst, për të vlerësuar nëse procedura në tërësinë e saj, ka qenë e drejtë, rëndësi duhet t'i kushtohet nëse të drejtat e mbrojtjes janë respektuar. Pra, në këtë kontekst, duhet të vlerësohet nëse veçanërisht parashtresve të kërkesave u është dhënë mundësia e kundërshtimit të provave kundër tyre. Për më tepër, kualiteti i provave duhet të merret parasysh, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat, dhe nëse kjo paraqet dyshim sa i përket besueshmërisë dhe saktësisë së tyre. Përderisa nuk mund të thuhet që mund të vjen në shprehje domosdoshmërisht çështja e një gjykimi të drejtë kur prova e marrë është e mbështetur me materiale të tjera, duhet të theksohet se kur prova është shumë e fortë, dhe nuk ka rrezik që një provë e tillë të jetë e pabesueshme, atëherë nevoja për prova mbështetëse është më e vogël (shih, rastet e GJEDNj-së *Boykov kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 90; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 35 dhe 37; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 43). Andaj, për të konstatuar nëse në një rast të caktuar mund të ketë shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, është e rëndësishë thelbësore për konstatimin nëse prova e marrë në mënyrë të paligjshme, ka qenë provë e vetme dhe vendimtare lidhur me rastin konkret.

b) aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

64. Gjykata rikujton që parashtresi i kërkesës pretendon se pranueshmëria e provave është marrë në kundërshtim me dispozitat e KPPRK-së dhe të drejtën për një gjykim të

drejtë dhe të paanshëm, sepse shpallja fajtores e tij është bazuar në deklaratimet e B. Sh., të cilën e kishte dhënë në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë së tij.

65. Gjykata sa i përket këtij pretendimi konkret i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, e cila arsyetoi se: *“... parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur deklaratën e tërësishme të dëshmitarit B. Sh., sepse ai ka deklaruar se sa i përket bashkëkryerjes së veprës penale me të dënuarin Menderes Sinani qëndron pranë pranimi të fajësisë, e në anën tjetër gjykata e shkallës së parë ka administruar, vlerësuar dhe arsyetuar shumë prova për bashkëkryerjen e tyre, prej të cilave këtu do përmenden ato siç janë se bashkërisht shumë herë kanë kontaktuar drejtpërsëdrejti me të dëmtuarin B. S. dhe familjarët e tij, e kanë vizituar në shtëpinë e tij, janë takuar në restorante dhe vende tjera, i kanë përsëritur kontaktet edhe kur ai për herë të dytë është paraburgosur, kanë potencuar se “do t’i ndihmojnë në çështjen penale të veprës së trafikimit me njerëz, ashtu që nuk ishte relevante se konkretisht cilit prej tyre i është dorëzuar ryshfeti, por se janë plotësuar të gjitha elementet thelbësore të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343. par.1. të KPK-së”.*
66. Gjykata, para se të konkludojë përkitazi me këtë pretendim konkret, rikujton se është përtej juridiksionit të saj si Gjykatë Kushtetuese, të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave të rregullta, lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë marrë në mënyrë haptazi arbitrare. Gjykata Kushtetuese, bazuar në juridiksionin e saj nuk ndërhyr as në mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë pranuar provat si material dëshmues dhe as në diskrecionin e tyre përkitazi me vlerësimin e vlerës dëshmuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj-së, *Doorson kundër Holandës*, paragrafi 78). Ajo çfarë është e rëndësishme në lidhje me çështjen e provave është vlerësimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese, nëse parashtuesit e kërkesës në mënyrë efektive kanë mundur t’i kundërshtojnë provat dhe dëshmitë kundër tij.
67. Në këtë drejtim, për t’i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtuesve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në kushte të njëjta në gjykatë. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës KI42/16, parashtues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
68. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Gjykatës Supreme përkitazi me këtë pretendim konkret, vëren se parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi efektive për të prezantuar rastin e tij dhe për të kundërshtuar ligjshmërinë dhe mënyrën e marrjes së provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre, dhe se këtë mundësi e shfrytëzoi, nëpërmjet ushtrimit të ankesës në gjykatën e shkallës së dytë, duke i përsëritur të njëjtat pretendime edhe në Gjykatën Supreme, nëpërmjet ushtrimit e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Andaj, në lidhje me këtë Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta i shqyrtuan pretendimet e tij edhe përkitazi me pranueshmërinë e provave dhe mbi bazueshmërinë e argumenteve dhanë arsye për vendimmarrjen e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, *Dragojević kundër Kroacisë*, nr. 68955/11, Aktgjykim i 15 janarit 2015, paragrafi 132).
69. Andaj, Gjykata, në dritën e shqyrtimeve dhe arsyetimeve të lartcekura, si dhe duke marrë parasysh parimet e përgjithshme përkitazi me pranueshmërinë dhe ligjshmërinë e marrjes së provave, në këtë çështje penale, konstaton se në rastin konkret, gjykatat e rregullta sikundër dhe Gjykata Supreme, si instancë përfundimtare e gjyqësorit të rregullt nuk ia ka mohuar parashtuesit të kërkesës të drejtën për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, në lidhje me këtë pretendim konkret.

70. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me ligjshmërinë e marrjes së provave i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Vlerësimi i pretendimeve për shkelje të nenit 36 të Kushtetutës në lidhje me nenin 8 të KEDNj-së

71. Gjykata rikujton se përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu në shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] të KEDNj-së, duke theksuar se në pikën 4 dhe 6 të shtojcës së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e të dënuarit B. Sh., të 29 prillit 2015, atij i është zbuluar jeta private dhe familjare, për faktin se nga kjo marrëveshje janë cituar pjesë të deklarimeve të të dënuarit B. Sh-së, të cilat flasin për raportet e tij private me familjen, e të cilat nuk ndërlidheshin asgjë me pranueshmërinë e provave.
72. Gjykata, para së gjithash, rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesave kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që kërkesa t'i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Njëri ndër to është edhe ai i shterimit të mjeteve efektive juridike në procedura të rregullta pranë gjykatave të juridiksionit të rregullt.
73. Gjykata tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, më parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96, dhe së fundmi, rastin KI189/19, parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59). Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin e materies/substancës, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dyja kuptimet, në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafin 94).
74. Aspekti i shterimit të mjeteve juridike në substancë është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNj-së dhe të Kushtetutës duhet të jenë ngritur “të paktën në substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI01/19, parashtrues: *Fatos Rizvanolli*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).
75. Në këtë drejtim, GJEDNj gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike, edhe nëse gjykatat e

rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (*ex officio*) pretendimet përkatëse (shih, për më tepër përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin e materies/substancës, udhëzuesin e GJEDNj-së, të 30 prillit 2019, Pjesa I. Bazat procedurale të papranueshmërisë; A. Mosshterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; d. Pretendimet e Ngritura në Substancë).

76. Për më tepër, GJEDNj mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNj-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72, dhe së fundmi rastin KI189/19, parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59).
77. Në këtë kontekst, Gjykata duke iu referuar shkresave të lëndës, vëren se ky pretendim asnjëherë nuk është ngritur as si i nënkuptuar dhe as në materie (substancë), si shkelje e të drejtave kushtetuese dhe e KEDNj-së, të paktën në riprocedurë penale pranë gjykatave të rregullta, kur dihet se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ishte pjesë e gjykimit penal në rastin e të dënuarit B. Sh. dhe e parashtruesit të kërkesës nga 2015. Prandaj, Gjykata e ka të pamundur ta trajtojë dhe analizojë tutje këtë pretendim në materie, nëse ka pasur shkelje të privatësisë, jetës private dhe familjare apo jo, ngase kërkesa në këtë pjesë nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, në kuptim të ngritjes së shkeljes në substancë në gjykatat e rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI68/21, parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 3 nëntorit 2021, paragrafët -58-66).
78. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu se, përjashtimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike vjen në shprehje vetëm atëherë kur Gjykata bindet se shfrytëzimi i mjetit juridik përkatës mund të mos jetë efektiv në dhënien e një përgjigjeje të arsyetuar, një pretendim të ngritur nga parashtruesit e kërkesave në instanca përkatëse. Në rastin konkret, pretendimi i parashtruesit të kërkesës bie në fushëveprimin e nenit 36 të Kushtetutës, andaj, duke pasur parasysh parimet kushtetuese të përcaktuara me nenet 53 dhe 102.3 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se kjo mundësi duhet shfrytëzuar nga parashtruesit e kërkesës.
79. Andaj, duke i marrë parasysh këto shtjellime, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë as Gjykatës së Apelit dhe as Gjykatës Supreme të adresojnë këtë pretendim dhe të korrigjojnë shkeljen e pretenduar të së drejtës në privatësi. Rrjedhimisht, kërkesa në këtë pjesë deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

III. Sa i përket pretendimeve të tjera

80. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm përmend nenin 54 të Kushtetutës, megjithatë ai nuk shtjellon tutje, se si dhe pse ka ardhur deri të shkelja e këtij neni specifik. Gjykata përsërit se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe

argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIo4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).

81. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për “mbrojtjes gjyqësore të të drejtave”, i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si i tillë i njëjti, duhet shpallur qartazi i pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundime

82. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përkitazi me “*të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor*” dhe përkitazi me “*pranueshmërinë dhe ligjshmërinë e provave*” i përket kategorisë së tretë (III), nënkategorisë (b), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, të njëjtat i shpallë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 36 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNj-së, duhet të shpallet i papranueshëm në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1, b) të Rregullores së punës, për shkak të mosshterjes në substancë të mjeteve juridike në gjykatat e rregullta; iii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, i përket kategorisë së tretë (III), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si i tillë edhe ky pretendim duhet të shpallet qartazi i pabazuar, në baza kushtetuese.
83. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1, b) dhe (2), si dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 22 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani